



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS

Durrës 04.05.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

- Cilat janë kriteret e punësimit të kujdestareve?

Organika e insitucionit "Shtëpia e foshnjës" bazohet në urdhrin e Kryeministrit nr.88 datë 25.10.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Social Shtetëror", ku është dërguar zyrtarisht nga Ministria e Punës, Cështjeve Sociale dhe Shanseve të barabarta dhe zbatimi i strukturës dhe organikës për Shtëpinë e Foshnjës Durrës.

Sipas organikës së sipërcituar kriteret për punësimin bazohen në nenin 20 të LIGJIT Nr.7961, datë 12.7.1995 "KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i ndryshuar

- Cfarë arsimimi duhet të kenë?

Në referim të skemës së organikës miratuar me nr 2/20, pozicioni Kujdestar është i parashikuar në kuadër të sektorit të shërbimit social pa një përcaktim të shprehur dhe të detajuar mbi profilin e detyrueshëm profesional që duhet të ketë punëmarrësi, duke lënë hapësirë që plotësimi i tij të bëhet në varësi të nevojave të institucionit me funksionin e kujdesit ndaj fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç.

Megjithatë të gjithë kujdestarët që prej fillimit të tyre ndjekin vazhdimisht trajnime dhe kurse të posaçme të organizuara nga Ministria përkatëse, Shërbimi Social në bashkëpunim dhe me organizata të ndryshme. Këto trajnime shërbejnë për të siguruar që personeli/kujdestari të jetë e aftë të përmbushë detyrat funksionale të cilat synojnë rritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të kujdesit, mbrojtjes dhe

mirëqënies së fëmijëve. Shtëpia e foshnjës disponon dhe një pasqyrë të të gjitha trajnimeve ndër vite.

Gjithashtu përmes kërkesës së drejtuesit, sektori social bën vlerësime periodike përmes një formulari vlerësimi për çdo kujdestar.

- Lidhur me transferimin e zonjës Dallëndyshe Hajrullaj, cilat kanë qenë arsyet e transferimit të paraqitura pranë jush?

Pranë Bashkisë Durrës është depozituar kërkesa për lëvizje nga detyra nr. 4478 prot datë 02.04.2026, duke bashkëlidhur dhe procesverbalet e mbajtura me nr.102 dt 19.03.2026 të mbledhjes së këshillit administrativ të institucionit dhe nr.102/1 dt 24.03.2026 ku sjelljet e përsëritura dhe të konstatuara nga këshilli e kanë bërë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve në këtë insitucion.

- E nëse janë të njëjtat si pretendimet e transmetuara, janë verifikuar?

Transferimi i punonjësës nuk konsiderohet si një masë ndëshkuese ndaj saj, por si një riorganizim institucional i cili synon vijimin normal të shërbimit dhe shmangien e konflikteve në institucione publike, për të siguruar një ambient të qetë dhe profesional pune dhe ky transferim është ndërmarrë në përputhje me kompetencat e punëdhënësit, mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe respektimin e Kodit të etikës

Përsa i përket rastit të fëmijës të raportuar nga media juaj, Bashkia Durrës ka ngritur grupin e punës për verifikimin e plotë të rrethanave të rastit.